



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 35
Prishtinë, më 25.01.2012, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Rasim Demiri dhe Emin Gërbeshi

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli dhe Zarife Aliu

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i Rendit të ditës;**
2. **Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 10.01.2012;**
3. **Raportimi i Kryeshefit ekzekutiv të Inspektoratit Policor të Kosovës;**
4. **Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.*

Kryetari i Komisionit- Filloj takimin e radhës së Komisioni, ky takim është thirrur në bazë të Raportit të dërguar nga Inspektorati Policor i Kosovës., fjalën ia kaloi Kryeshefit të Inspektoratit Policor të Kosovës për diskutimin e Raportit të paraqitur për vitin 2011, pastaj anëtarët e Komisionit vazhdojnë me pyetje dhe sugjerime.

Kryeshefi i Inspektoratit Policor të Kosovës, z. Fitim Shishani- Para se të fillojmë analizën e Raportit të vitit 2011, do të doja të ju informoja mbi fushë veprimtarinë e Inspektoratit Policor të Kosovës dhe segmentet që e rrethojnë.

Inspektorati Policor i Kosovës është themeluar në vitin 2006 nga OSBE-ja, dhe deri në dhjetor të 2010 ka pasur mandat ligjor të bëjë hetimin e rasteve disiplinore të veprave me karakter disiplinor të supozuara si të kryera nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës. Nga 1 dhjetori i vitit 2010 me ligj Inspektoratit Policor i janë autorizuar edhe disa kompetenca shtesë të cilat janë: ndalimi, luftimi i veprave penale të cilat mund të kryhen nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës pa dallim grade apo pozicioni që kanë në Polici, gjithashtu Ligji i jep të drejtën Inspektoratit Policor që të angazhohet edhe për parandalimin e rasteve disiplinore.

Për rastet disiplinore ne kemi autorizime ligjore të bëjmë parandalimin, zbulimin si dhe argumentimin e rasteve me karakter disiplinor të nivelit të lartë menaxherial dhe të nivelit të lartë ekzekutiv. Misioni i Inspektoratit Policor të Kosovës është i proklamuar tashmë duke ushtruar veprimtarinë, autorizimet që i takojnë duke siguruar një llogaridhënie efikase të shërbimeve të Policisë së Kosovës në mënyrë që të jetë transparent, demokratik dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës, aktet normative ndërkombëtare, kodin e etikës evropiane etj.

Inspektorati Policor i Kosovës që nga themelimi e deri tani, ka kaluar nëpër disa faza të zhvillimit, të cilat në aspektin organizativ nuk kanë qenë të lehta, por që nga qershori i vitit 2011 është bërë një sistematizim i Inspektoratit Policor të Kosovës në aspektin organizativ, që ka të bëjë me organizimin e brendshëm dhe funksional që ka të bëjë me kompetencat, dhe nga dy Departamente Operative dhe Departamentit të Administratës, tani kemi edhe dy Departamente të tjera që janë, Departamenti për grumbullimin e informacioneve dhe përzgjedhjen e tyre si dhe Departamenti për testin e Integritetit.

Sfida tjetër e Inspektoratit Policor të Kosovës ka të bëjë me buxhetin e pa mjaftueshëm që posedon, megjithatë kemi arritur me kohë të përgatisim dokumentet juridike për të kërkuar mbështetje dhe përkrahje nga Ministria e Punëve të Brendshme, si institucion i pavarur nga Policia, mjete buxhetore shtesë. Kjo gjë akoma nuk është realizuar, pasi siç mund ta shihni edhe në Raportin e Inspektoratit Policor, në Departamentin ku nevojiten 35 punonjës aty janë 17 punonjës dhe Departamenti ku nevojiten 20 punonjës aty janë 8 punonjës. Si rezultat i kësaj nuk kemi arritur të realizojmë strukturën organizative të Inspektoratit Policor të Kosovës.

Një segment tjetër i rëndësishëm është ai që, menaxhmenti është duke bërë përpjekje për arritjen e një marrëveshje me Drejtorinë e Policisë dhe Ministrin e Punëve të Brendshme për të bërë transferimin e disa zyrtarëve me përvojë nga Policia e Kosovës, pas dorëheqjes së tyre nga Policia, kjo për arsye se shumë vende në rajon kanë ndjekur këtë praktikë dhe është treguar e suksesshme. Stafi që është tani në Inspektoratin Policor të Kosovës, është trajnuar nga OSBE-ja por jo në sferën marrjes në pyetje të pjesëtarëve të Policisë të akuzuar për vepër penale.

Gjithashtu në kuadër të udhëzimeve administrative që e shoqërojnë ligjin për zbatim, kemi përgatitur një Strategji të Inspektoratit Policor të Kosovës dhe në kuadër të kësaj Strategjie është edhe plani operacional për realizimin e secilit objektivi që parashihet për tu realizuar nga Inspektorati Policor i Kosovës për periudhën kohore 2012-2015- të.

Kryetari i Komisionit- Ne si Komision e kemi Raportin e 2011. Ajo çfarë duam të dimë është, sa të punësuar keni aktualisht në Inspektoratin Policor të Kosovës dhe sa janë planifikuar për vitin 2012?

Kryeshefi i Inspektoratit Policor- Momentalisht të punësuar janë 43 punonjës, ndërsa për 2012 kemi kërkuar 15 persona. Sipas strukturës Inspektorati Policor në mënyrë që të operoj ashtu siç duhet, duhet të jenë 92 zyrtar për të operuar për një periudhë të gjatë kohore.

Inspektorati Policor i Kosovës, ka nevojë për Hetues dhe për këtë ne kemi bërë kornizën buxhetore para se buxheti të aprovohet, në mënyrë që të dihen nevojat që kemi si Inspektorat në mënyrë që të realizohen. Nga Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri kërkojmë mbështetje në Kuvend, në mënyrë që të ofrohet mbështetje nga buxheti i Kosovës për Inspektoratin Policor.

Kryetari i Komisionit- Në bazë të skemës buxhetore që kemi, në Raport thuhet që janë paraparë 50 të punësuar. Ky projekt buxhet është aprovuar, mund të rishikohet. Rishikimi zakonisht bëhet në qershor, dhe ju si Inspektorat Policor dërgojeni një Kërkesë në mënyrë që të kemi parasysh nevojat e juaja dhe të ju përkrahim si Komision, në mënyrë që të keni buxhet më shumë. Duke ditur rrethanat dhe kushtet që veproni si Inspektorat Policor, nuk do të kërkojmë perfektshmëri, por do të veprojmë me kushtet që ekzistojnë në Kosovë

Obligimi i Komisionit është përkrahja e institucioneve që i ka në mbikëqyrje si Ministrinë e Punëve të Brendshme, Agjencitë që kanë të bëjnë me sigurinë e vendit si dhe Ministrinë e FSK-së. Obligimi i parë është të ju japim mbështetje ligjore dhe mundësi të tjera, në mënyrë që këto institucione të jenë sa më vitale në punën e tyre dhe pastaj kërkojmë Raporte për punën e bërë.

Vërejtjet tona si Komision për Inspektoratin Policor kanë të bëjnë me punësimin, ne kemi të dhëna se ka transferim të punonjësve nga një Agjenci në tjetrën, sugjerojmë që të respektoni Ligjin për Administratën për punësim, vërejtja e dytë ka të bëjë me shkeljet që mund të jenë bërë gjatë gjithë vitit nga Policia e Kosovës ndaj të drejtave të njeriut dhe kompetencave dhe përfshirja e Inspektoratit Policor në ndërhyrjen e punës së Policisë së Kosovës. Ne si Komision sugjerojmë që ju të kryeni punën në mënyrën më të mirë të mundshme në mënyrë që mos të ketë ndërhyrje, përzierje të kompetencave dhe që mos të bien në ndesh me ligjin.

Kryeshefi i Inspektoratit Policor- Ne kemi caktuar 50 punonjës për vitin 2012 pasi me kohë e kemi vërejtur që numri për 65 punonjës nuk ka qenë e mundur, bazuar në qarkoren buxhetore, por bashkë me Ministrinë e Punëve të Brendshme po bashkëpunojmë në mënyrë që të shikojmë modalitetin për të realizuar aspektin buxhetor. Ndërsa sa i përket transfereve që mund të jenë bërë nga Agjencitë e ndryshme në Inspektoratin Policor, menaxhmenti nuk ka marrë asnjë veprim pa u bazuar në rregullat, ligjet për këtë qëllim, bazuar në Ligjin e Inspektoratit Policor të Kosovës.

Transferimet që janë bërë, janë bërë në bazë të Ligjit për Shërbyesit Civil dhe kanë qenë horizontale dhe vertikale, transferimi horizontal është aplikuar në Inspektoratin Policor, marrja e një punonjësi nga një Agjension dhe departament të njëjtë. Sa i përket ndërhyrjes së Inspektoratit Policor në punët e Policisë, në Raport janë të përfshira të dhënat për veprat penale, llojet e veprave penale, numrin e pjesëmarrësve të cilat i kemi kualifikuar bashkë me Prokurorin dhe të gjitha ngjarjet janë pasqyruar në Raport.

Përfshirja e Inspektoratit Policor në punët policore, sa i përket këtyre rasteve, për të gjithë ata të cilët janë përfshirë në punët policore kemi marrë masa dhe nuk kanë vazhduar më punën si hetues, arsyeja është etike, morale dhe njerëzore. Ju garantoj që punonjësit e Inspektoratit Policor kanë qenë për ta monitoruar gjendjen në bazë të mandatit që kanë. Menaxhmenti i IPK-së nuk do të mbrojë askënd nëse ka shkelur dispozitat ligjore.

Nëse shohim ligjin e IPK-së, ligjvënësi ka lënë disa zbrazëtira, ku thotë, *hetuesit kanë autorizime policore*. Me autorizim policor nënkuptojmë të drejtën e pjesëtarit të autorizuar për të bastisur, burgosur, marrjen e njerëzve në pyetje, por gjithashtu edhe në nenin 17, paragrafi 1 dhe 3 të ligjit të IPK-së, hetuesit kanë të drejtë për armëmbajtje, pranga dhe segmente të tjera të sigurisë dhe këto kompetenca i kanë për policët, për ata që kryejnë vepra penale si pjesëtar të policisë. Sa i përket ngjarjeve të 14 janarit 2012, e kemi Raportet ku ka pasur raste të kërkimi të ndihmës nga policët, por pas kësaj është kthyer në detyrën e tij si monitorues.

Kryetari i Komisionit- Sa i përket transferimeve që mund të bëhen nga institucione të tjera në Inspektoratin Policor, një gjë e tillë është e garantuar edhe me ligj, neni 28 të transferimit të nëpunësve civil, por kur kjo kthehet në dukuri ndikon në zbehjen e institucioneve, do të ishte mirë që këto të bëheshin me konkurse. Gjithashtu në nenin 208 të procedurës penale, që e saktëson se cili është roli i Inspektorit ose Hetuesit në rastet kur një person bën shkelje të ligjit qoftë polic ose qytetar i zakonshëm, por obligimi është që duhet dorëzuar në Policisë.

Referuar në ngjarjet e 14 janarit ka pasur raste kur Polici bashkë me hetuesin e kryejnë detyrën e njëjtë gjë që nuk është pasqyrë e mirë. Është kompetencë e jona si Komision të mbikëqyrim këto raste, të shqyrtojmë dhe të kërkojmë që mos të ndodhin, pasi nga rastet krijohen dukuri, krejt kjo që të mos krijohet imazh i keq në opinion.

Rexhep Selimi- Do të adresoj dy çështje, e para çështjen e involvimit të Hetuesit të Inspektoratit Policor në punët policore, ne duam të dimë se çfarë keni bërë ju si Inspektorat Policor, si e keni proceduar kur një pjesëtar i Policisë involvohet në ushtrimin e dhunës ndaj një protestuesi (referuar ngjarjeve të 14 janarit 2012) sesa tendencë për ta arrestuar?

Referuar Raportit të Mediave të cilat pasqyrojnë një situatë të tillë, prandaj pyetja që lind këtu është. A ka qenë Polici i rrezikuar në atë masë sa të kërkoj ndihmë? A e konfirmoni që ka ndodhur një gjë e tillë? Pasi ne nuk kemi një Raport nga Inspektorati Policor sa i përket kësaj ndërhyrje. A ka pasur të drejtë të ndërhyj në një rast të tillë Hetuesi i Inspektoratit Policor, a ka qenë në përputhje me mandatin e tij?

Nëse ju e vlerësoni që nuk ka pasur të drejtë, cilat janë masat administrative që do të ndërmerreni ndaj Hetuesve që mund të kenë ndërhyrë në punët policore?

Për këto pyetje mund ti përgjigjeni me shkrim ose me Raportim në Komision në takimet e radhës.

Pyetje tjetër është se, në Raportin tuaj a e keni përfshirë një rast të datës 12 maj 2011, ku në njërin nga protestat, një pjesëtar i administratës i Ministrisë së Punëve të Brendshme i cili merre pjesë në rrahjen e një protestuesi, duke mos pasur mandat për një gjë të tillë.

A e keni evidentuar këtë rast, çfarë masa keni marrë, pasi në këtë rast ka bërë shkelje edhe Policia e cila ke lejuar të ndodhë kjo. Përmenda këto dy raste, pasi këto konsiderohen si të vetmet në këtë shkallë.

Pyetje tjetër ka të bëjë me dinamikën e lëndëve. Cila është dinamika, dhe a keni arritur dinamikën e mjaftueshme për trajtimin e këtyre rasteve?

Kryeshefi i Inspektoratit Policor- Sa i përket rastit të datës 12 maj 2011 në protestat e zhvilluara, Inspektorati Policor i Kosovës ka mandat të hetimi, parandalimit dhe zbulimit nga data 1 qershor 2011. Referuar rastit të datës 12 maj 2011, mandati ka qenë i dikujt tjetër. Edhe nëse ky rast do të kishte qenë vepër penale, nuk do të trajtohej nga ne, pasi ne nuk kemi pasur mandat.

Sa i përket trajtimi të lëndëve, më tepër se 600 raste janë transferuar në Polici pasi kanë qenë lëndë me karakter jo penal. Dinamika e trajtimit të lëndëve penale është e përshkruar në Raport,

kallxime penale, akuza. Gjykatat janë të furnizuara me lëndë nga veprimtaria të karakterizuara në bazë të veprës penale për Prokurori Komunale dhe të Qarkut. Përpiqemi të jemi proaktiv deri në momentin e dorëzimit të rastit te Prokurori në mbledhjen e materialit, marrjes në pyetje, por ne nuk ndalemi me kaq, interesohemi për zgjidhjen e lëndëve në Prokurori. Për këtë çështje na është caktuar një prokuror i veçantë(Isuf Mezini).

Referuar Raportit të Medias për rastet e involvimit të pjesëtarëve të Inspektoratit Policor në punët e Policisë, përdorim dhune nuk ka pasur, bazuar edhe në Raportin e Policisë përshkruhet nevoja e Policisë për mbështetje në një rast të tillë. Inspektorati i Policisë ka dal edhe me një deklaratë për Media lidhur me këtë çështje. Sa i përket masave për ti ndërmarr, si menaxhment mendojmë që të merren disa veprime etike ndërsa nga ana profesionale nuk ka pasur shkelje.

Goran Marinković – Bazuar në Raportin e paraqitur nga Inspektorati Policor i Kosovës, nga paraqitja e të dhënave në të krijohet një imazh jo i mirë për Kosovës, si veprat penale, marrja e mitos etj, shpresojmë që për vitin e ardhshëm ky Raport të jetë më pozitiv. Pyetja që kam është. A është plotësuar nga Inspektorati Policor kriteri i përfaqësimit të pakicave dhe a respektohen procedurat për pranimin në punë, pasi ka kuadro në radhët e minoriteteve që mund ta bëjnë këtë punë?

Kryeshefi i Inspektoratit Policor- Ju falënderoj për interesimin që shprehni për mbarrëvajtjen e Inspektoratit Policor, numrin e veprave penale është shqetësues edhe për menaxhmentin e Inspektoratit, por është detyra jonë për identifikim e veprave penale që mund të kryhen brenda Institucionit të Policisë së Kosovës, ti argumentojmë në Prokurori, në mënyrë që persona të tillë të mos jenë më pjesëtar të Policisë.

Sa i përket kuotës për minoritetet, si drejtues i këtij institucioni nga qershori i vitit 2011, nuk ka pasur asnjë pjesëtar nga minoriteti serb në Inspektoratin Policor të Kosovës. Më janë dhënë informacione se kanë qenë dy pjesëtarë nga minoriteti serb, por për disa veprime nga ana e tyre si shkelja e udhëzimeve administrative të cilat e ndalojnë shpërndarjen e informatave nga Inspektorati Policor ndaj tyre janë marrë masë disiplinore.

Qëllimi jonë është në rritjen e numrit të punonjësve në Inspektoratin Policor të Kosovës me përvojë policore, pasi kjo është nevojë imediate e Inspektoratit Policor. Me zëvendës Ministrin e Punëve të Brendshme kemi rënë dakord që të ketë edhe pjesëtar nga komuniteti serb në Inspektoratin Policor, përveç kësaj shqetësuese është edhe kuota gjinore në aspektin e hetimeve, inspektimeve por kjo çështje do të zgjidhet duke përfshirë njerëz në baza ligjore brenda Inspektoratit Policor.

Trajnimet për pjesëtarët e Inspektoratit Policor janë të shumta, mbështetje për këtë ka dhënë OSBE-ja, ICITAT-i, me ndihmën e tyre është përgatitur një nevojë vjetore për trajnime për Inspektoratin Policor dhe kemi identifikuar se cilat trajnime nevojiten për vitin 2012, nga momenti i shkrimit të raporteve deri te segmenti i arrestimit, se si kryhet si ndërmerret një arrestim.

Goran Marinković- Cilat kanë qenë arsyet e largimit të dy pjesëtarëve të komunitetit serb nga Inspektorati Policor i Kosovës?

Kryeshefi i Inspektoratit Policor- Në bazë të Raporteve të Inspektoratit Policor të Kosovës, arsyeja e largimit të punonjësve nga Inspektorati Policor ka pasur shpërndarje të informacioneve tek personat e pa autorizuar për këto informacione.

Fatmir Xhelili- Jemi të vetëdijshëm që me ndryshimin e ligjit për Inspektoratin Policor është ndërruar dhe qëllimi dhe misioni i Inspektoratit dhe paraqet vështirësi, pasi fillimisht janë trajnuar për tu marrë me masa disiplinore për zyrtarët policor ndërsa tani do të merren me hetimin e zyrtarëve policor dhe qytetarëve të cilët implikohen bashkë me zyrtarët policor në aktivitete kriminale.

Pyetjet që kamë janë. A keni përcaktuar me rregullore kriteret për përcaktimin e mënyrës së bërjes Inspektor i Inspektoratit Policor? A do të jetë Policia e Kosovës burim i vetëm për kuadro në Inspektorat apo do të përcaktoheni për mënyrën e posaçme të edukime dhe trajnimeve të kandidatëve që do të bëhen Inspektor në Inspektoratin Policor?

A ka bërë Inspektorati Policor vlerësimin e forcës që është përdorur nga zyrtarët policor, a ka qenë kjo forcë në përputhje me ligjin për situata të tilla, apo është tejkaluar përdorimi i saj nga strukturat policore?

Pasi lëndët disiplinore nga 1 qershor 2011 kanë kaluar ne Policinë e Kosovës, zgjidhja e tyre do të bëhet nga Policia apo Inspektorati do të merret me lëndët e akumuluar deri më 1 qershor 2011 në Inspektoratin Policor?

Kryeshefi i Inspektoratit Policor- Sa i përket rregullores për përzgjedhjen e kandidatëve, me udhëzime janë përcaktuar mënyrat e përzgjedhjes së punonjësve të Inspektoratit të Policisë dhe duke pasur parasysh që mandati jonë është mbikëqyrja e Policisë së Kosovës, do të ishte e rrugës që njohuritë e kuadrove të Inspektoratit mbi funksionimin e Policisë të ishin në nivelin e njëjtë profesional, prandaj kriteret do të jenë të njëjta me ato të policisë dhe trajnimi të bëhet njëjtë si ai i Policisë, për gjashtë muaj, pra trajnimi bazik i Policisë.

Sa i përket tejkallimit të përdorimit të forcës nga zyrtarët policor, ne akoma jemi në fazën e vlerësimit të informacionit që posedojmë, ky proces ka dy faza, faza e parë ka konsistuar në grumbullimin e informacioneve nga mediat, burime të tjera dhe faza e dytë, analizimi i këtij informacioni dhe më vonë do të jete Raporti i Inspektoratit Policor lidhur me këtë çështje.

Ndërsa lëndët të cilat kanë kaluar tek Policia deri me 1 qershor 2011, me të gjitha ato merret Policia përfshirë edhe veprat penale, kundërvajtjet dhe veprat disiplinore, ndërsa nga 1 qershor 2011 Inspektorati Policor i Kosovës ka mandatin për vepra penale, disiplinore për zyrtarët policor të nivelit të lartë.

Drejtori i Departamentit të Hetimeve, Z. Arben Vrajolli- Inspektimi është në procedurë, si staf profesional jemi të thirrur për vlerësimin e kryerjes së detyrave të Policisë, ne nuk mundemi të nxjerrim përfundime pa konsultuar informacionin që kemi dhe do të mbledhim, përfshirë faktet nga Mediat, intervistat e ndryshme dëshmitë e zyrtarëve policor, dhe në këto momente jemi në fazën e analizimit të fakteve deri në dhënien e konkluzave.

Ganimete Musliu- Shpresoj që në të ardhmen Policia dhe Inspektorët policor të jenë të përgatitur dhe mos të ketë përzierje të kompetencave, referuar ngjarjeve të fundit të cilat kanë krijuar konfuzion në publik.

Anton Quni- Më interesojnë disa forma të punës që i aplikoni. Në Raportin e 2011 shkruhet që janë pranuar 649 ankesa nga qytetarët por nuk ka informacione sa çështje keni ngritur si Inspektorat pa inicimin e qytetarëve, dhe a e aplikoni këtë formë dhe si i trajtoni?

Sa e preferoni preventivën në mënyrë që mos të ndodhin shkelje, a keni drejtë si Inspektorat që të ndërhyjnë dhe të paralajmëroni zyrtarët policor që nëse veprojnë në një mënyrë të caktuar do të ndeshen me ligjin në periudha parapërgatitore për një situatë të caktuar, si shembull menaxhimi i turmave?

A e keni të drejtën e hetimit dhe inspektimit të operacionit, taktikave të veprimit?

Kryeshefi i Inspektoratit Policor- Tek të dhënat që përfshihen në Raport, 649 ankesa nga qytetarët, ka pasur raste të lajmëruar nga qytetarët dhe raste proaktive të gjitha këto kanë shkuar për Policinë, ndërsa sa i përket rasteve proaktive, para se të lajmërohen nga qytetarët kemi raste të tilla, kur Inspektorët e kanë vëzhguar situatën duke marrë më pas masat e duhura.

Drejtori i Departamentit të Hetimeve, Z. Arben Vrajolli- Sa i përket të drejtës së pjesëmarrjes së Inspektoratit në planifikimet që bëhen nga Policia, nuk mund të jemi pjesë e tyre, kjo konsiderohet përzierje në kompetencat e Policisë, e jo të përfshihemi në planet operative, pasi mandati jonë është ta mbikëqyrim Policinë. Planet Operative të Policisë kemi të drejtë ti inspektojmë pasi ai ka përfunduar, një gjë e tillë do të aplikohet edhe në ngjarjet e 14 janarit 2011 dhe që bazohemi në standarde të veprimit dhe vlerësojmë se a ka vepruar në bazë të procedurave që i ka aprovuar gjatë hartimit të planit operativ . Ne bëjmë rekomandime që këto parime dhe procedura të avancohen.

Kryetari i Komisionit- Në konceptin e menaxhimit të turmave veprohet kështu, Komandanti fushor, Komandanti i Policisë ose Zv. Komandanti jep urdhrin, negocimi, 20 minuta afat për shpërndarje në rastin tone 5 minuta.

Pyetja është, a mund të kërkon ju si Inspektorat Policor përgjigjeje, pse është dhënë një kohë kaq e shkurtër prej 5 min. E jo një kohë prej 20 min. Në distancën e paraparë prej 5 deri në 20 metra , ashtu siç parashihet për menaxhimin e turmave?

Kryeshefi i Inspektoratit Policor- Ne bëjmë inspektimin e këtyre rasteve, dhe në fund bëjmë raport, por në aspektin profesional është Policia ajo që e vlerëson situatën, pasi shpeshherë situata na dikton se si të veprojmë. Si Inspektorat do të bëjmë një Raport Objektiv dhe bazuar në vlerësime objektive.

Rexhep Selimi- Si anëtarë i Komisionit, dhe për këtë kërkoj edhe mbështetjen e anëtarëve të tjerë që, nga Inspektorati Policor të kemi një Raport Objektiv dhe zyrtar në mënyrë që ti referohemi dhe në të, të përfshihen të gjitha rastet e diskutuara edhe në media, në Raport të ketë edhe vlerësim nga Inspektorati Policor se në ngjarjet e 14 janarit 2011 a ka pasur tejkalim të kompetencave të strukturave policore gjithashtu të përfshihet se a janë respektuar procedurat e përshkallëzimit të përdorimit të forcës duke iu referuar manualeve të Policisë së Kosovës për menaxhimin e turmave.

Kryeshefi i Inspektoratit Policor- Të gjitha rekomandimet, sugjerimet e dhëna nga ju do të merren parasysh, si Inspektorat jemi në fazën e dytë të vlerësimit të informacioneve dhe të gjitha sugjerimet të merren parasysh, Raporti do të jetë sa më shpejtë të jetë i mundur.

Kryetari i Komisionit- Ky takim është i rregullt për raportim në Komisionin për Punë të Brendshme Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së nga Inspektorati Policor i Kosovës.

Drejtori i Policisë ka raportuar pranë këtij Komisioni, Ministri i Punëve të Brendshme, Ministri i FSK-së, Komandanti i FSK-së, Këshilli i Sigurisë Kombëtare janë institucione të cilat raportojnë në Komision, pra kjo është pjesë e agjendës.

Në përfundim të këtij takimi falënderoi Kryeshefin e Inspektoratit Policor për raportim dhe prezencë, e konsideroi mbledhjen e mbyllur, ndërsa **miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së**

Komisionit, të mbajtur më 10.01.2012, i cili është pika e dytë e rendit të ditës mbetet për mbledhjen e radhës së Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi